


Ikona “Shën Nikolla” ka qenë pjesë e regjistrit të poshtëm të ikonostasit të kishës “Ipapandia” në Progër të Korçës dhe është pikturuar nga A.N.Ballamaçi rreth vitit 1884



Ajo është pikturuar mbi një panel druri të përbërë nga dy dërrasa. Paneli rruhet mirë ndërsa grunti dhe shtresa e pikturës kanë pësuar dëmtime sidomos përgjatë perimetrit. Copa gazetash që duhet të jenë përdorur për paketim kur ikona është transportuar nga vendi ku ndodhej për në fondet e MKAM janë ngjitur mbi sipërfaqen e saj. Punët konservuese që u kryen përfshinë konsolidimin e grunit dhe pikturës te zonat e dëmtuara , largimin e vernikut të oksiduar dhe letrave e depozitimeve të tjera mbi të dhe ndërhyrje estetike me ngjyra akuareli. Në fund ikona u mbulua me disa shtresa të holla verniku.